


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIK MALLAKASTËR

Ballshinë, 29.01.2026

PROCESVERBAL

I mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Mallakastër. Kryesues i mbledhjes është Z. Nexhmi Sulaj. Ora e mbledhjes: 14:00. Kryesuesi i mbledhjes deklaroi kuorumin prej 12 anëtarësh. Të pranishëm nga administrata: Z. Fitim Bare, Z. Aleksandër Rama, Znj. Kleidja Hoxhaj, Z. Guri Nuhaj, Z. Izet Ymeraj.

Kryetari i Këshillit e hap mbledhjen me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes më datë 23.12.2025.
3. **Projektvendim Nr.01:** Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën me fondet e pushtetit qendror dhe vendor për vitin 2026.
4. **Projektvendim Nr.02:** Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%.
5. **Projektvendim Nr.03:** Për miratimin e listës së përfaqësuesve të Bashkisë Mallakastër në bordin e institucionit arsimor Mallakastër.
6. **Projektvendim Nr.04:** Për pagesën e vlerës së qirasë familjes së z.Arjan Shehaj, banori fshatit Damës, Njësia Administrative Fratar, Bashkia Mallakastër.
7. **Projektvendim Nr.05:** Për një ndryshim në VKB Nr.50, datë 23.12.2025 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Mallakastër, institucioneve në varësi, funksioneve të transferuara dhe deleguara për vitin 2026.
8. **Projektvendim Nr.06:** Për miratimin e një shtese e rishpërndarje të fondeve buxhetore për vitin 2026, nga të ardhurat e trashëguara nga viti 2025.

Janë dhe dy projektvendime shtesë, kush është dakord t'i fusim në këtë rend dite?

Projektvendim Nr.07: Për një ndryshim në vendimin nr.52 datë 23.12.2025 ‘Për miratimin e financimeve të ndarë në tre vite’.

Projektvendim Nr.08: Për miratimin e përdorimit të grantit me bazë performance e fituar për vitin 2025 dhe shtim buxheti për vitin 2026.

Votojnë 12 pro, asnjë kundër, asnjë apstenim. Miratohet.

Kalojmë te pika 2, sekretare të lutem na bëj me dije vendimet nga procesverbali i mbledhjes së kaluar.

Vendim Nr.43: Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%.

Vendim Nr.44: Për miratimin e listës së përfituesve të bursave për nxënësit që ndjekin vitin e parë në shkollat e mesme të arsimit profesional për vitin shkollor 2025-2026.

Vendim Nr.45: Për miratimin e listës së përfituesve të bursave për nxënësit që ndjekin arsimin në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2025-2026.

Vendim Nr.46: Për miratimin e pagës së punonjësve mësimor efektiv (instruktor) në shkollat e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët që kryejnë orë mësimi shtesë, Bashkia Mallakastër.

Vendim Nr 47: Për miratimin e performancës të vitit 2025.

Vendim Nr.48: Për miratimin e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 dhe të buxhetit vjetor 2027.

Vendim Nr.49: Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Mallakastër dhe institucioneve në varësi për vitin 2026.

Vendim Nr 50: Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Mallakastër, institucioneve në varësi, funksioneve të transferuara dhe deleguara për vitin 2026.

Vendim Nr.51: Për miratimin e buxhetit të vitit 2026, dokumentit përfundimtar të projektbuxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe numrit të përgjithshëm të punonjësve.

Vendim Nr 52: Për miratimin e financimit të ndarë në tre vite.

Vazhdojmë me rendin e ditës, pikën 3: Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën me fondet e pushtetit qendror dhe vendor për vitin 2026.

Znj. Kleidja Hoxhaj: Atëhere, pak a shumë kriteret janë të njëjtat me kriteret që ne kemi përzgjedhur edhe vitin e kaluar, nuk janë ndryshuar, sepse janë të bazuara në ligjin për ndihmën ekonomike, ligji nr.57/2019, janë përfshirë të gjitha kategoritë që shërbimi social mbështet me pagesa të ndryshme. Nuk e di nëse ka ndonjë sygjërim nga këshilltarët për ndonjë kriter shtesë, le të thonë.

Z. Klodjan Shehaj: A përfshihen familjet Rome dhe egjiptiane?

Znj. Kleidja Hoxhaj: Po, natyrisht që përfshihen, ato që janë familje në nevojë, pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme, nuk bëhet diferencim për këto familje.

Z. Nexhmi Sulaj: Pra nuk kanë asnjë ndryshim nga familjet e tjera që trajtohen me ndihmë ekonomike.

Znj. Kleidja Hoxhaj: Po, nuk kanë diferencim, trajtohen njëjloj.

Z. Lefter Rabiçaj: Këto kriteret janë shumë të forta, dhe a nuk ka një ndryshim në vlerën e përfituar, mqs paga minimale ndryshoi? Dhe mund të bëjmë zbutje të këtyre kriterëve që masa përfituese të jenë më shumë.

Znj. Kleidja Hoxhaj: Jo, deri në këtë moment nuk ka asnjë vendim për rritje të kësaj vlere.

Z. Qerim Ismailaj: Profesor, kur thua për masën, e ke fjalën për masën përfituese si numër apo të vlerës që ata përfitojnë?

Z. Lefter Rabiçaj: të Dyj, sepse sa më të lehta kriteret, aq më shumë familje përfitojnë dhe pjesa e vlerës që ata marrin, për deri sa u rrit paga min, të rritet dhe vlera që këta përfitojnë, se këta nga 20 e ca mijë lekë përfitojnë.

Z.Qerim Ismailaj: Pjesa e kritereve është e përcaktuar me ligj, nuk e ndryshojmë dot, dhe fondi vjen i përcaktuar në total, sepse edhe nëse pëjmë zbutje të kritereve do të rritet masa përfituese, dhe me çfarë do mbulohen këto shpenzime? Për këtë vit shuma, edhe pse është e përcaktuar, ka ardhur me rritje në krahasim me vitin e kaluar.

Znj.Sabire Hoxhaj: Nëse një person trajtohet me ndihmë ekonomike nga blloku qëndror ose dhe nga 6%, për sa kohë mund të vazhdoj?

Znj. Kleidja Hoxhaj: Sipas ligjit, personat që trajtohen me ndihmë ekonomike, kanë një afat kohor prej pesë vitesh. Pas pesë vitesh, sistemi i skualifikon vet këto rast, por ka pasur raste që kanë filluar dhe më shumë se pesë vite, p.sh në rastin e grave kryefamiljare.

Z. Nexhmi Sulaj: Atëhere kishte ndonjë gjë tjetër për te kriteret, nëse jo, e hedhim në votim,votojnë 12 pro, asnjë kundër, asnjë apstenim. Miratohet.

Kalojmë në pikën katër të rendit të ditës; Projektvendim Nr.02: Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%. Nëse keni ndonjë pyetje.

Znj. Sabire Hoxhaj: Jo, nuk kemi, mqs e diskutuam më parë.

E hidhet në votim; votojnë 12 pro, asnjë kundër, asnjë apstenim, miratohet.

Z.Nexhmi Sulaj: Kalojmë në pikën pesë të rendit të ditës; Projektvendim Nr.03: Për miratimin e listës së përfaqësuesve të Bashkisë Mallakastër në bordin e institucionit arsimor Mallakastër. Në këtë projektvendim, bashkia ka vendosur emrat e disa punonjësve të bashkisë, të cilët do të jenë në bordin përfaqësues të Bashkisë Mallakastër.

Z.Lefter Rabiçaj: Një pyetje kam në lidhje me anëtarët e bordit, dihet që ligji për arsimin parauniversitar thotë që anëtarët e bordit duhet të jenë nga bashkia, por çfarë kritereesh plotësojnë këta anëtarë bordi, sepse ai do vlerësoi punën e drejtorit të shkollës. Ka diçka në krijim e këtij bordi, që most ë jetë faktike, duhet të plotësojnë disa kritere.

Z. Klodjan Shehaj: Në bazë të ligjit të arsimit parauniversitar thuhet se duhet një përfaqësues i bashkisë si anëtarë bordi.

Z. Qerim Ismailaj: Atë po thotë dhe profesori, ku jemi bazuar dhe cilat janë kriteret profesionale. Professor, në ligj nuk thuhet kjo gjë, që duhet të ketë këtë profil ose arsimim, por ne jemi nisur, duke gjykuar dhe për shkak të profesionit, pjesa më e madhe e këtyre antërëve janë mësues me profesion, por për hir të së vërtetës nuk është se do i marr vendimet vetmë përfaqësuesi i bashkisë.

Z. Lefter Rabiçaj: Përfaqësuesi i bashkisë luan rol të veçant, mos thoni kështu.

Z. Qerim Ismailaj: Dakord Jam, por bashkia më shumë rol luan në nrgohje, pastrim, pagesa të faturave të ujit e dritave,etj. Ky është një detyrim ligjor që duhet ta përmbushim.

Znj. Lindita Ymeraj: Për mua emrat e punonjësve nuk vihen në diskutim

Z.Lefter Rabiçaj: e thash që nuk kam asgjë kundër emrave që janë në list, por pieta në bazë të çfarë kritereve janë përzgjedhur, sepse këta vlerësojnë dhe punën e një drejtori shkolle.

Z. Qerim Ismailaj: Përfashto vetëm njërin prej tyre, të gjithë të tjerët janë mësues.

Z. Nexhmi Sulaj: Atëherë e hedhim në votim, kush është pro kësaj listës? Votojnë 12 pro, asnjë kundër, asnjë apstenim, miratohet.

Vazhdojmë me pikën gjashtë të rendit të ditës; Projektvendim Nr.04: Për pagesën e vlerës së qirasë familjes së z.Arjan Shehaj, banori fshatit Damës, Njësia Administrative Fratar, Bashkia Mallakastër. Ju i keni lexuar të dhënat e këtij personi, pornë qoftë se ka nevojë për sqarime të mëtejshme, kush do ti referoj?

Z. Izet Ymeraj: sipas informacioneve dhe verifikimeve që kemi bërë në terren, më datë 8 janar, nga kushtet e këqija atmosferike, ka ndodhur shpërbërja e pjesës së murit të jashtëm të kësaj banese, dhe për të mos rrezikuar jetën e banorëve të kësaj banese, kemi mbajtur procesverbal dhe i kemi kërkuar qytetarit që ta largohet familjarisht nga banesa, dhe të strehohet diku tjetër, dhe i kemi kërkuar qytetarit që të bëjë një kërkesë për bonus qiraje, për të ndjekur gjithë procedurat ligjore dhe për ta strehuar diku tjetër, për një afat një vjeçar, që ky bonus qiraje të paguhet nga bashkia. Qytetari aktualisht ka lidhur një kontratë qiraje për një ambient tjetër në Damës, me Z.Selman Taraj.

Z. Qerim Ismailaj: Izet, banesa është e pabanueshme?

Z.Izet Ymeraj: Po.

Z.Qerim Ismailaj: Të bëjmë disa sqarime, jo gjithkush mund të marrë bonusin e qirasë, pornë këtë rast përveç dëmtimit të murit mbajtës së shtëpisë ka dhe spostim të çatisë, dhe banesa aka dal jashtë funksionit të banimit që ajo ka, dhe si e tillë, është gjetur kjo zgjidhja tjetër.

Z. Iqbal Rabaj: Duhet t'a thoni atje në relacion, arsyet e shembjes së kësaj banese, amortizimi a, shkarje a, tërmet a, shkakët pra që e kanë çuar në këtë gjendje.

Z. Izet Ymeraj: Atëherë, objekt është ndërtuar para viteve 70, dhe është objekt tejet i amortizuar.

Z. Përparim Bengaj: Po pas një viti çfarë ndodh me këta qytetar? Sepse një vit ikën shumë shpejt.

Z.Qerim Ismailaj: Për deri sap o flasim për këto kushte, është një mbështetje emergjente, dhe kjo supozohet si kohë e mjaftueshme për të gjetur qytetari një zgjidhje, sepse ne e dim tani më që ka shumë banesa të vjetra që kanë problem, lidhur tani më dhe me numrin e aplikimeve në programin tjetër, banesat në Mallakastër të viteve 50, 60, 70, qoftë për shkak të strukturës por dhe ndërtimit me baltë e byk, natyrisht që vjen një moment dhe amortizohen, dhe këto patjetër që kanë nevojë për rikonstruksion, një pjesë e madhe kanë bërë banesa të reja, por për ata që s'kanë mundësi, shteti ka gjithmonë detyrimin për këto banesa që t'i mirëmbajë ose të ndihmojë këto familje, dhe një mënyrë është dhënia e bonusit të qirasë, me afat maksimal dy vjeçar, dmth kur mbaron një vit me të drejtë rinovimi, gjithmonë duke parë dhe efektet financiare të bashkisë, sepse natyrisht s'mund të vazhdojmë me të gjithë në këtë mënyrë, se mund të ketë shumë raste, në këtë rast ndihmesa lidhet me kushtet e emergjencës dhe nënkupton një afat të shkurtër jo afatgjatë.

Znj. Sabire Hoxhaj: Më vjen mirë faktikisht, që u shprehët me nota shumë positive, marr parasysh dhe raportin e komisionit, sepse kur njeriu ka një hall dhe dikush tjetër e ndihmonë kjo e bën të ndihet më mirë, dhe e vërteta është që ajo shtëpi është ngjitur me një shtëpi tjetër, kanë çati të përbashkët dhe nuk mund të bëhet dot asnjë ndërhyrje, sepse personi tjetër ka qenë në Itali, dhe s'merret dot leje për rikonstruksion. Ai nuk është një djalë që pret t'i bjerë nga qielli, ai është një djalë punëtor, por e ka të pamundur të bëjë ndërhyrje në këto kushte që ndodhet shtëpia.

Z. Qerim Ismailaj: Dëgjo Sabire, potë mos ishte në këto kushte, të jeni të qartë që nuk do ndërhyjmë, por ky është realiteti. Nuk ka raste me fenomenin apo personin në fjalë, sepse ne kemi pasur dhe raste të tjera, psh një rast në Visokë, një rast në Aranitas, më duket ai vazhdon akoma me bonus qiraje, Z.Faik Avdulaj, këto janë raste të trajtuara, ne po bëjmë detyrën tonë.

Znj. Sabire Hoxhaj: Nëse keni mundësi e përfshini në rast se merrni grante për rikonstruksione.

Z. Qerim Ismailaj: Jo, sepse në atë program që përfshihemi ne nuk mund të bëhet rikonstruksion total i banesa që janë në këtë gjendje, ai projekt është për ato banesa që kanë nevojë për rikonstrukcione të pjesëshme, psh çatia, dyer, dritare, suvatime, etj.

Znj.Sabire Hoxhaj: Dakord. Por ai a mund të investoj vet Brenda atyre mureve që ka?

Z. Izet Ymeraj: Ne e kemi sqaruar, në bazë të procedurave, sepse ai nuk do t'a lëri objektin në gjendjen që e ka, ai do investoi Brenda atij konturi, asaj gjurme që ka, nuk duhet të bëj ndryshim destinacioni, ngritje kati apo diçka tjetër, edhe çatin që e ka bashkë me komshinë nuk mund të bëj ndërhyrje pa bër një kontratë marrveshje mirëkuptimi.

Z.Qerim Ismailaj: Duhet të gjej mirëkuptimin, se vjen ankohet ai qytetari tjetër dhe pastaj ndërhyjnë instanca të tjera, p.sh IMt-ja.

Z. Nexhmi Sulaj: Mirë atëherë e hedhim në votim, kush është pro, 11, kundra s'ka, apstenim 1, miratohet.

Kalojmë në pikën 7, projektvendimi nr. 05: Për një ndryshim në VKB Nr.50, datë 23.12.2025 "Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkë Mallakastër, institucioneve në varësi, funksioneve të transferuara dhe deleguara për vitin 2026. E kaluam një të tillë muajin që shkoi, mirë po me ndryshimin e nivelit të pagës minimale janë bërë disa ndryshime të tjera, atëherë kryetar kush do relatoi për këtë projektvendim?

Z. Qerim Ismailaj: Të nderuar këshilltarë, që në mbledhjen e parë e dim që do të ndryshonte niveli i pagës minimale, por deri në momentin që kemi pasur mbledhjen e datës 23 dhjetor, nuk kishte dal akoma Vendimi i Këshillit të Mistrave, dhe nuk mund të procedonim me ndryshimin e nivelit të pagave. Natyrisht për reflektimin e kësaj VKM-je kemi paraqitur një projektvendim, kemi bërë dhe disa diskutime qoftë me sektorin e burimeve njerëzore, qoftë me drejtorin ekonomike lidhur me përballimin e njësisë të rritjes së pagave dhe kur kemi llogaritur buxhetin, kemi parashikuar praktikisht për të pasur një efekt financiar të përbalueshëm nga buxheti i bashkisë për këto ndryshime në nivelin e pagave. Këto ndryshime janë paraqitur dhe në tabelat, të cilat fillojnë nga lidhja nr.2, për punonjësit me arsim të mesëm profesional, pra te lidhja nr.2 pika katër dhe pika tetë, dua të sqaroj një gjë; është duke u diskutuar një VKM tjetër, e cila do të diskutohet dhe në këshillin konsultativ të bashkive, ku do të ketë dhe disa ndryshime të tjera. Përveç specilaistëve me arsim të lart dhe për punonjës me specifika të veçanta, dhe këtu flas duke filluar nga topografët, ekonomist me arsim të mesëm, teknikët e mesëm, manovrator, shofer kamioni, elektrikist, etj me radhë. Dhe për momentin kemi bërë një përjasje, por mund të kemi një rishikim në bazë të atij vendimi që pritet të dal, në rast se do ketë rritje, por nuk përjashtohet dhe për disa pozicione të caktuara të ketë ulje, konkretisht për të gjitha vlerat që janë mbi 57 mijë lekë mund të zbresin në 57 mijë lekë., dhe pot ë shikoni pika 8 është bërë për miratim 59 mijë, por mund të shkoj 57 mijë, në varësi të VKM-së që pritet të dal. Pse është parashikuar kështu, sepse me ligjin e vjetër, për funksionet e varësisë, ne kishim të drejtë me këshillin bashkiak të përcaktonim nivel pagash, por duke ruajtur hierarkin e pagave, që do të thotë jo më lart se specilaisti i IV-4-rës, pra jo më lart se 60 mijë lekë, i cili është niveli maksimal i kategorisë për specialistin IV-4. Dhe vazhdon e njëjta llogjikë dhe për funksionet në varësi, si është policia bashkiak, pra nga 59 mijë mund të shkoj në 57 mijë, e njëjta gjë vlen dhe për lidhjen nr.4; këtu kemi parashikuar me 50 mijë lekë edukatorët me arsim të mesëm.

Për mbrojtjen nga zjarri është e miratuar dhe nuk ka asnjë ndryshim, për QKF-në e njëjta gjë, për drejtorat e kopshtin vazhdon me të njëjtin nivel, edhe për gjendjen civile po e njëjta gjë. Ajo që ka më shumë ndryshime është lidhja nr.8 e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike.

Dhe në fund, miratimi i tre kategorive për vështirësi pune (manovratorë, etj.) me një shtesë prej 6000 lekësh.

Nëse ka pyetje?

Z. Oldison Caushaj: Pse do hapen vetëm dy qendra, Hekal dhe Aranitas? Çfarë funksionesh kanë dhe kur fillojnë?

Z. Qerim Ismailaj: Fillojnë më 2 shkurt. Janë marrë parasysh kërkesat e qytetarëve në dëgjuesat publike. Do të jenë katër funksione: P.A.K (Personat me Aftësi të Kufizuara), aplikimet online, punonjës topograf dhe kadastrë. Po diskutohet edhe reforma territoriale dhe duhet t'i japim rëndësi bashkisë, për të mos qenë vetëm me një njësi administrative.

Z. Klodjan Shehaj: A mund të bëhet një ndryshim për përgjegjësin e sektorit të lidhja nr. 02? A ka mundësi për shtesë?

Z. Qerim Ismailaj: Sipas VKM 503, datë 1.08.2024 – Përgjegjisi i sektorit ka fashën 70 - 105 dhe ne e kemi përcaktuar 87 mijë lekë.

Z. Lefter Rabaj: Jam për rritje për të gjitha nivelet e pagave, por jam që specialistët e të dy kategorive III-3 dhe IV-4 të shkojnë në maksimum. Tek lidhja nr. 08, për punonjësit mirëmbajtës, nga 59 t'i çojmë 60 (mijë), pse të jemi dorështrënguar?

Duke pasur parasysh se fondin e këshillit s'e kemi harxhuar, pas kryetarit dhe nënkryetarit vjen sekretari i këshillit; pse s'njësohet me të tjerët? Unë propozoj që sekretarit t'i bëhet rritje page me 10 mijë lekë, pasi kemi çuar paga të tjera në tavan. Këto janë propozimet e mia, nuk e di sa do merren në konsideratë. V.K.M-ja thotë se drejtori i kabinetit dhe sekretari i këshillit kanë të njëjtin nivel.

Z. Qerim Ismailaj: Te pjesa e punëtorëve të krahut, po të më lejonte ligji s'do ta lija 57 (mijë) psh. për mirëmbajtësit, por do t'i çoja 75 mijë. Vitin e kaluar i kishim punonjësit me 40 mijë dhe i çuam 52 mijë. Flas për shërbimet mbështetëse, por po e çuam 60 mijë, ai s'ka më diferencë me specialistin me shkollë të lartë.

Lidhur me hierarkinë e pagave për sekretarin e këshillit dhe drejtorin e kabinetit, duhet të kemi kujdes mos të kemi disnivel. Sekretari i këshillit është njësoj me drejtorët e drejtorive. Do ta diskutojmë, por duhet bërë një bilanc. Atëherë i shikojmë me radhë të gjitha lidhjet, për çdo pozicion:

Z. Lefter Rabaj: Performanca e Bashkisë është e mirë dhe ka marrë fonde shtesë, dhe këtë punë të mirë e ke bërë me këta njerëz.

VOTIMI:

E hedhim në votim: Votojnë 12 PRO, 0 KUNDËR. Miratohet.

Pika tjetër: Projektvendimi Nr. 06 – Për miratimin e një shtese e rishpërndarje të fondeve buxhetore për vitin 2026, nga të ardhurat e trashëguara nga viti 2025.

Z. Aleksandër Rama: Është akorduar një fond prej 3 milionë lekë shtesë për 3% e punonjësve që qeveria na i kthen dhe duhet rishpërndarë për rritjen e nivelit të pagave dhe për N.Sh.P-në.

Nga këto fonde do shpërndahet për investime. Për vitin 2026 kishim parashikuar 4 projekte për rikonstrukcionin e rrugëve në qytet dhe në Njësitë Administrative. Në bazë të këtij fondi, për rrugët e Ballshit shtohen 39 milionë lekë. Për rrugët e Fratarit shtohen 8 milionë lekë dhe 8 milionë lekë të tjera.

Të tre këto fonde i përkasin fondit të vitit 2026 për likuidim. Një pjesë e këtij fondi shkon për pajisjen e dy Njësiteve Administrative që do të hapen. Një shtesë fondi prej 2 milionë lekësh shkon për kondicionimin e Pallatit të Kulturës etj.

Në pjesën e dytë të projektvendimit janë likuidimet për rrugët e fshatit Kremenar. Këto lekë që kanë tepruar kanë kaluar te N.Sh.P-ja dhe në Bashki për shpenzime operative.

Z. Lefter Rabaj: Te tabela e parë, te zëri 600 dhe 601 (paga dhe sigurime).

Z. Aleksandër Rama: Janë dy njësi shpenzuese: Bashkia dhe N.Sh.P.

Z. Lefter Rabaj: Keni pakësuar te mbikëqyrjet dhe e keni shtuar te zëri 602.

Z. Qerim Ismailaj: Ishte parashikuar në buxhet, por kur u bë prokurimi u ul vlera. Për rrugën e Ngraçanit dhe likuidimin që është kryer për një punim, mbetjet janë caktuar te vlera e shpenzimeve operative. Për rrugët e Ngraçanit dhe Kremenarit nuk mund të bënim paradhënie. Nga grant ii performancës: 1 milion nga buxheti i shtetit është shpërndar, kurse nga fond i huaj nuk është përcaktuar se ku do të shpenzohen.

E hedhim në votim, votojnë 12 pro, asnjë kundër, asnjë apstenim. Miratohet.

Kalojmë në projektvendimin Nr.07- Për një ndryshim në vendimin nr.52 datë 23.12.2025 'Për miratimin e financimeve të ndarë në tre vite'. I cili u sqarua më lartë me ndryshimet dhe shtesa që ishin pasqyruar në projektvendimin nr.06. E hedhim në votim, votojnë 12 pro, 0 kundër, 0 apstenim. Miratohet.

Projektvendimi Nr.08: Për miratimin e përdorimit të grantit me bazë performance e fituar për vitin 2025 dhe shtim buxheti për vitin 2026.

Z. Aleksandër Rama: ky është një fond, që nuk lejohet vetëm për pagat, por është për çdo lloj investimi, i cili ishte i pasqyruar te projektvendimi nr 07.

**MBAJTËS I PROCESVERBALIT
SEKRETARI I KËSHILLIT**

Zinaida Ahmetaj

